

# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTETËRIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

Bordi i FMK-së në bazë të nenit 41 paragrafi 12 pika (g) të Statutit të Federatës së Mundjes të Kosovës, në mbledhjen e vetë të mbajtur 06.10.2022 miratojë:

Rregullore mbi kriteret e vlerësimit të sportistëve.

## Neni 1

Kjo rregullore përcakton kriteret e vlerësimit të mundësav në bazë të rezultateve të arritura në aktivitetet zyrtare të FMK-së si dhe aktivitete të tjera që nihen nga FMK.

## Neni 2

Më këtë rregullore përcaktohen nivelet e mundësav për të gjitha grupmoshat dhe për të dy gjinitë si Shpërblimet; Pjesëmarrja me Reprerentacion në gara ndërkombëtare; Klasifikimi për Bursa si Shpresë Olimpikë; Shpresat e sportit të Mundjes; Sportist i vitit.

## Neni 2.1


Shpresa e sportit të mundjes do të shpallen mundësit e moshës deri në 14 vjeç(vajzat), dhe 16 vjeç (meshkujt), në bazë të rezultateve të arritura në garat zyrtare që nihen nga FMK-së.

## Neni 3

Për të qenë kandidat për bursën si Shprese Olimpikë mundësi duhet të jetë në moshën e përcaktuar nga rregullorja e MKRS(deri 20 vjet) për ndarjen e bursave për shpresa Olimpikë, duhet të ketë rezultatet patjetër të jetë kampion shtetëror të paktën në garat e vitit paraprak, dhe gjithashtu të jetë mundës -e aktiv që stërvitet rregullisht, anëtar i rregullt i reprerentacionit dhe gjithashtu sportist që ka respektuar në tersi rregulloret dhe statutin e FMK-së(mundësit-e që nuk ka asnjë vërejtje gjatë aktiviteteve më FMK-së).

## Neni 4

Në ekipin e reprerentacionit marrin pjesë të gjithë ata mundës-e të cilët ftohen nga selektori i reprerentacionit mvarsisht nga aktiviteti si :gara, përgatitje të përbashkëta, kamp, seminar, në të cilin do të jenë pjesëmarrës.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHITËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

## Neni 4.1

Mundesat që marrin pjesë në reprezentacion janë të obliguar që tu përmbahen rregullave që i përcakton selektori dhe mbikëqyrësi i reprezentacionit në përpikëri, (si përgjigjeje me kohë për pjesëmarrje ose jo, bartja e pajisjeve të reprezentacionit, respektimi i orareve qofshin stërvitorë ose përgatitëse për gara, respektimi i orarit të gjumit, respektimi i orarit të ushqimit).

## Neni 4.2

Në rast se një mundës-e i thyen rregullat e parashtruara nga selektori dhe përgjegjësi i reprezentacionit, do të dënohet konform rregullores disiplinore të FMK-së, dhe gjithashtu edhe mund të shpërblehet për sjellje të mirë.

## Neni 4.3

Mundësi që nuk i përgjigjet më kohë ftesës së bërë nga federata ose për problem jo të arsyeshme nuk i lajmërohet me kohë federatës do të humbë të drejtën për tu ftuar në reprezentacion për një kohë të caktuar të cilën e propozon selektori në bashkëpunim me komisionin profesional dhe e miraton bordi i FMK-së.

## Neni 4.4


Për të fituar të drejtën për pjesëmarrje në reprezentacion varësisht nga kategoria, mosha sportisti duhet të plotësoj di sa norma, të jete kampion absolut në kategorinë e tij në garat vendore, të ketë performance të mirë në gara ndërkombëtare.

## Neni 5

Sportist (Mundës-e), të reprezentacionit mund të jenë të gjithë mundësit që kanë nënshtetësi të Kosovës dhe më vetë dëshirë i pranojnë ngjyrat e reprezentacionit të Kosovës.

## Neni 6

Obligohen të gjithë anëtarët e FMK-së (Bordi dhe Komisioni Profesional), që të hulumtojnë për sportist (mundës-e) shtetas Kosovar, të niveleve të larta që aktivitetin e vet e zhvillojnë në klube të shteteve tjera, dhe të evidentojnë cilësitë e këtyre sportistëve në mënyrë që të jemi në kontakte të përhershëm me këta sportist.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FA X: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

## Neni 7

Shpërblimet e parapara me rregulloret e MKRS, mund ti gëzojnë vetëm sportistët që kanë nënshtetësi të Kosovës dhe që aktivitetin e tyre e zhvillojnë në klubet e licencuara në FMK-së.

## Neni 8

Sportist (mundës-e) elitar janë të gjithë sportistët që arrijnë kuota të larta të performances në garat vendore dhe ndërkombëtare ,dhe për këta mundës FMK-së obligohet që të ndërmarrë masa për sigurimin dhe mbështetjen financiare duke kërkuar nga MKRS dhe nga buxheti i FMK-së,të ju ndahen mjete materiale për pjesëmarrje në kampe intensive dhe të kenë mbështetje të përhershme deri sa janë aktiv si mundës ashtu edhe Trajneri i tyre.,

## Neni 9

Përzgjedhja e mundesav bëhet në bazë të rezultateve të arritura në gara vendore ,regionale dhe ndërkombëtare .

## Neni 10

Obligohet selektori i reprezentacionit që të raportoj me shkrim ,në FMK-së për performancën e secilit mundës në çdo garë ku marrin pjesë me reprezentacionin,si për rezultatet ashtu edhe për sjellje.

## Neni 11


Në të gjitha garat ku merre pjesë reprezentacioni nën udhëheqjen e FMK-së, reprezentacioni udhëhiqet nga Selektori në mungesë të selektorit udhëhiqet nga trajnerët të cilët i cakton Bordi i FMK-së.

## Neni 12

Klubet që janë të licencuara në FMK-së janë të obliguara që të lajmëroj FMK-së për pjesëmarrje në aktivitete, pa marr parasysh se ku zhvillohen ato edhe pse janë të financuara nga vetë klubet në mënyrë që rezultatet që arrihen të jenë të arkivuara dhe të njohura nga FMK-së, në të kundërtën rezultatet e arritura mund edhe të mos merren për bazë nga FMK-së.

## Neni 13

Sportist të vitit mund të shpallen sportistët që kanë qenë pjesëmarrës në shumicën e aktiviteteve të organizuara nga FMK-së dhe kanë arritur rezultate të mira në këto aktivitete, gjithashtu edhe rezultatet e arritura jashtë vendit në gara ndërkombëtare që paraprakisht janë pranuar nga FMK. Sportist i vitit shpallet sportisti që merre pikë në bazë të tabelave me **nr .1**. Klubi më i mirë për vitin kalendarik do të shpallet klubi që tubon më së shumti pikë në kategorinë e të rriturve (Senior) .



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

Garat ku marrin pike sportistet	Vendi i -I-	Vendi i -II-	Vendi -III-	Pjesëmarrja
Olimpiada	100	90	80	50
Kampionati Botëror	90	80	70	40
Kampionati Evropian	70	60	50	30
Kampionati Ballkanik	60	50	40	20
Lojërat Mesdhetare	60	50	40	20
Universiada Botërore	60	50	40	20
Kampionati i Kosovës	50	40	30	5
Turne ne kalendarin e UWW	40	30	20	10
Turne ndërkombëtar	30	20	10	5
Turne mbarëkombëtar	20	10	5	

### Neni 13.1

Sportistet ne te gjitha kategoritë (Senior,Junior,Kadet dhe Pionier) do te vlerësohen me pike: Olimpiada, Kampionati Botëror,Evropian ,Ballkanik dhe i Kosovës ,Lojërat Mesdhetar ,Universiada Botërore, Turne ne kalendarin e UWW-se, Turne ndërkombëtare ,Turne mbarëkombëtar.

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i FMK-së.

Prishtine  
06.10.2022

Kryetari i FMK-se  
Naim Muja